

### Përmbledhje

Eurozona u karakterizua me tkurrje të aktivitetit ekonomik prej 1.8 përqind në TM1 2021, si pasojë e riprezantimit të masave kufizuese si pasojë e numrit më të lartë të rasteve të reja të të infektuarve me Covid-19. Ndërkohë që ishte parashikuar rënie më e fortë e aktivitetit ekonomik, masat e ndërmarra si stimujt e shtuar fiskal, rritja e kërkesës së jashtme, si dhe përshtatja më e mirë e agjentëve ekonomik me masat e kontrollit ndikuan në zbutje të efekteve të krizës pandemike. Në vendet e Ballkanit Perendimor janë shfaqur shenja të rikuperimit të aktivitetit ekonomik. Në TM1 2021 është vlerësuar të jetë shënuar një rritje mesatare ekonomike prej 0.8 përqind, ndërsa parashikimet e FMN-së për krejt vitin 2021 sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 5.1 përqind për rajonin.

Aktiviteti ekonomik në Kosovë u rikuperua gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, pas rënies që shënoi në vitin 2020. Në TM1 2021, rritja reale e BPV-së sipas ASK-së ishte 5.6 përqind, ku rritja e konsumit dhe investimeve kontribuan pozitivisht, përderisa eksportet neto kontribuan negativisht. Mbështetur në indikator me frekuencë më të lartë të publikimit si eksporti i mallrave dhe shërbimeve, konsumi dhe investimet publike, remitencat, etj., rritja reale e BPV-së vlerësohet të ketë vazhduar edhe në TM2 2021.

Çmimet e konsumit shënuan rritje mesatare vjetore prej 0.6 përqind në TM1 2021, kundrejtë tremujorit paraprak kur ishte shënuar rënie e çmimeve. Rritja e shënuar e çmimeve në TM1 2021 i'u atribua rritjes së çmimeve të mjeteve të komunikimit, pijeve alkoolike dhe duhanit, shërbimeve shëndetësore, arsimore, hoteliere, etj.

Zbutja e efekteve negative të pandemisë Covid-19 në ecurinë e ekonomisë së vendit ka ndikuar në përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore krahasuar me tremujorët paraprak. Të hyrat buxhetore në TM1 2021

shënuan rritje prej 14.5 përqind (2.2 përqind në TM1 2020), si rezultat i rritjes së pothuajse të gjitha kategorive.

Me rritje vjetore të përshpejtuar prej 30.5 përqind u karakterizuan edhe shpenzimet buxhetore, si rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale por edhe atyre rrjedhëse. Rritja më e lartë e shpenzimeve krahasuar me të hyrat buxhetore ndikoi që buxheti i Kosovës të regjistroj deficit primar prej 32.6 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.5 miliardë euro në TM1 2021, që është për 28.3 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind nga 16.5 përqind.

Asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.07 miliardë euro në TM1 2021. Krahasuar me TM1 2020, sistemi financiar është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar, kryesisht nga zhvillimet në sektorin bankar dhe atë pensional. Në sektorin bankar, aktiviteti kredihënës shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga investimet në letrat me vlerë dhe parasë së mbajtur në bankat komerciale. Në këtë periudhë me rritje të theksuar janë karakterizuar edhe depozitat e mbajtura në sektorin bankar. Sektori pensional u zgjerua si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe kontributeve të arkëtuara nga kontributdhënësit, duke rikuperuar plotësisht tërheqjen e 10 përqind të mjeteve të trusti, si masë në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike.

Në sektorin e jashtëm, deficitet i llogarisë rrjedhëse është më shumë se dyfishuar në TM1 2021, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të mallrave, përderisa bilanci pozitiv i shërbimeve dhe ai i të ardhurave dytësore kanë shënuar rritje. Deficiti tregtar i mallrave ishte 767.3 milionë euro apo 20.0 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2020, dinamikë që kryesisht i'u atribua rritjes së importit përkundër rritjes së konsiderueshme të eksportit. Në kuadër të bilancit të pagesave, rritje të konsiderueshme në TM1 2021 kanë shënuar edhe remitencat (29.7 përqind) ndërsa IHD-të shënuan rritje të ngadalësuar prej 2.0 përqind.

## PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje</b> -----	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>4</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>6</b>
<b>Sektori Real</b> -----	<b>6</b>
<b>Çmimet</b> -----	<b>6</b>
<b>Sektori Fiskal</b> -----	<b>7</b>
<b>Sektori Financiar</b> -----	<b>8</b>
<b>Sektori i Jashtëm</b> -----	<b>9</b>

## FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Norma e rritjes së BPV-së dhe inflacionit në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	07
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat-----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	11
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	13

## **SHKURTESAT:**

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BQE	Banka Qendrore Evropiane
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Përkeqësimi i krizës shëndetësore si pasojë e numrit më të lartë të rasteve të reja të të infektuarve me Covid-19 ndikoi që shumë vende të Eurozonës të zgjerojnë dhe forcojnë më tej masat kufizuese të lëvizjes dhe aktiviteteve në TM1 2021. Përkundër kësaj, tkurrja e aktivitetit ekonomik në Eurozonë prej 1.8 përqind (figura 1) ishte më e lehtë se sa që pritej kryesisht si rezultat i përforcimit të kërkesës së jashtme, stimujve të konsiderueshëm fiskal, por edhe me efektin e përshtatjes më të mirë të agjentëve ekonomik me masat e kontrollit.



Në mesin e vendeve kryesore të Eurozonës, Gjermania dhe Spanja raportuan rënie të aktivitetit ekonomik prej 3.0 përkatësisht 4.3 përqind, përderisa Franca raportoi rritje të aktivitetit ekonomik prej 1.5 përqind. Me zbutjen e masave të kontrollit, sidomos në gjysmën e dytë të vitit 2021, si dhe rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve si rezultat i vaksinimit masiv, BQE ka

parashikuar rikuperim të aktivitetit ekonomik prej 3.9 përqind në vitin 2021.

Shkalla mesatare e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në TM1 2021 arriti në 1.0 përqind (-0.3 përqind në TM4 2020). Rritja e çmimeve në Eurozonë kryesisht i'u atribua rritjes së çmimeve të shërbimeve dhe ushqimit, përderisa çmimet e energjisë kontribuan negativisht. Pavarësisht rritjes së çmimeve, kërkesa vendore mbetet e dobësuar. Si përgjigje ndaj kërkesës së dobësuar, në mars 2021, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi që të vazhdoj me blerjen e aseteve në kuadër të Programit Pandemik të Blerjes së Aseteve prej 1,850 miliardë euro deri të paktën në mars 2022. Po ashtu, këshilli drejtues i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normat kryesore të interesit, derisa shkalla e inflacionit i afrohet nivelit prej 2 përqind.

Në anën tjetër, aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 4.7 përqind në TM1 2021, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.8 përqind. Me rritje të lartë janë karakterizuar edhe depozitat, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 18.0 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 9.2 përqind.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat u goditën rëndë nga pandemia Covid-19 sidomos në TM2 dhe TM3 2020 (rënie mesatare prej 12.0 përkatësisht 8.3 përqind), kanë shfaqur shenja të rikuperimit ekonomik. Në TM4 2020<sup>1</sup> aktiviteti ekonomik në

<sup>1</sup> Të dhënat për TM1 2021 nuk janë publikuar ende.

vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare prej 1.2 përqind ndërsa në TM1 2021 aktiviteti ekonomik është rikuperuar mesatarisht për 0.8 përqind. Rritja më e lartë e aktivitetit ekonomik në TM1 2021 është shënuar në Kosovë dhe Shqipëri. Me rritje të aktivitetit ekonomik është karakterizuar edhe Serbia, ndërsa vendet tjera kanë shënuar rënie (tabela 1). Për vitin 2021, parashikimet e FMN-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënoi rritje mesatare prej 5.1 përqind.

**Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në B. Perëndimor**

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1
Serbia	2.6	2.9	4.9	6.3	5.2	-6.2	-1.4	-1.1	1.2
Mali i Zi	3.2	3.6	5.2	3.7	2.6	-20.3	-26.9	-7.5	-6.4
Kosova	4.3	2.9	6.0	5.6	1.6	-7.1	-6.3	0.8	5.6
Maqedonia e Veriut	1.4	4.3	3.6	3.3	0.9	-14.9	-3.3	-0.7	-1.9
Shqipëria	2.3	2.1	4.2	-0.1	-2.8	-11.3	-3.5	2.4	5.5

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Ngritje e lehtë e shkallës së inflacionit u raportua edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit në TM1 2021 ishte 1.0 përqind. Në Mal të Zi është shënuar një rënie e lehtë e çmimeve, ndërsa në vendet tjera të rajonit çmimet janë rritur (tabela 2).

**Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në B. Perëndimor**

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1
Kosova	3.2	3.3	2.6	1.7	1.1	0.2	-0.4	-0.1	0.6
Mali i Zi	0.4	0.5	-0.1	1.1	0.5	-1.1	-1.4	-1.3	-0.1
Maqedonia e Veriut	1.2	1.2	0.6	0.0	0.6	0.5	1.5	2.2	2.0
Serbia	2.4	2.3	1.3	1.4	1.7	1.0	1.9	1.6	1.4
Shqipëria	2.0	1.5	1.5	1.6	1.9	2.4	2.2	2.2	1.1

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit kreditues prej 5.4 përqind, që është normë më e ulët e rritjes krahasuar me normën prej 7.9 përqind në TM1 2020. Vendet të cilat shënuan normat më të larta të rritjes ishin Serbia dhe Kosova (8.8 përqind përkatësisht 7.7 përqind), pasuar nga Maqedonia e

Veriut (5.2 përqind), Mali i Zi (3.3 përqind) dhe Shqipëria (2.2 përqind). Depozitat shënuan rritje mesatare prej 9.5 përqind, që është normë më e lartë e rritjes krahasuar me rritjen prej 7.2 përqind në TM1 2020. Edhe tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Serbi dhe Kosovë (17.7 përkatësisht 15.0 përqind), pasuar nga Maqedonia e Veriut (7.4 përqind), Shqipëria (4.6 përqind) dhe Mali i Zi (2.8 përqind).


Gjatë TM1 2021, euro është vlerësuar ndaj valutave tjera: 32.1 përqind ndaj lirës turke, 9.4 përqind ndaj dollarit amerikan, 2.2 përqind ndaj frankës zvicerane, 1.5 përqind ndaj sterlinës britanike, 1.1 përqind ndaj kunës kroate, 0.5 përqind ndaj lekut shqiptar, etj.

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori Real

Si rezultat i pandemisë Covid-19 dhe masave që u ndërmorën për ruajtjen e shëndetit të publikut (kufizimi i lëvizjes, distancimi fizik, etj.), aktiviteti ekonomik ka shënuar rënie prej 3.0 përqind në vitin 2020. Rënia më e lartë e aktivitetit ekonomik është shënuar në TM2 dhe TM3 ndërsa në TM4 2020 aktiviteti ekonomik është rikuperuar në një masë duke shënuar rritje prej 0.8 përqind. Rritje e përsheptuar e aktivitetit ekonomik është shënuar në TM1 2021, ku norma e rritjes së BPV-së ka arrihur në 5.6 përqind. Konsumi dhe investimet kanë kontribuar pozitivisht me 7.5 përkatësisht 4.6 pikë përqindje, përderisa eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik me 6.5 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Sipas ASK-së, rritja më e lartë e BPV-së në TM1 2021 është shënuar në sektorin e shëndetësisë dhe punës sociale (26.3 përqind), ndërtimtarisë (11.5 përqind), administrimit publik (10.2 përqind), edukimit (9.6 përqind) dhe aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (8.9 përqind). Rritje prej 2.3 përqind është shënuar edhe

në sektorin e tregtisë si njëri ndër sektorët me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej aktivitetin ekonomik. Përveç vlerës së shtuar në BPV, rritje prej 15.7 përqind shënoi edhe indeksi i shitjeve neto në tregti. Në anën tjetër, në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz është shënuar rënie prej 9.9 përqind. Rënie e aktivitetit ekonomik është shënuar edhe në sektorin e industrisë nxjerrëse (-5.9 përqind) dhe atë të transportit dhe magazinimit (-3.1 përqind). Rënia e aktivitetit ekonomik në këta sektorë është evidentuar edhe tek indeksi i vëllimit të prodhimit ku industria nxjerrëse ka shënuar rënie prej 4.5 përqind ndërsa indeksi i shitjeve neto në sektorin e transportit dhe magazinimit ka shënuar rënie prej 8.0 përqind.


Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se trendi i përshpjeguar i rritjes së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në TM2 2021. Këto vlerësime mbështeten në indikacionet për rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e konsumit dhe investimeve publike, rritjen e remitencave, etj. Në anën tjetër, rritja shumë e lartë e importit të mallrave ka ndikuar negativisht rritjen e BPV-së.

Kriza pandemike dhe rënia e shënuar në sektor të caktuar ekonomik është shoqëruar me përkeqësim të treguesve kryesor të tregut të punës në vend. Sipas ASK-së, shkalla mesatare e punësimit për vitin 2020 ka rënë në 28.4 nga 30.1 përqind sa ishte në vitin 2019, ndërsa shkalla e papunësisë së regjistruar ka arritur në 27.0 përqind në TM4 2020, nga 25.9 përqind sa ishte në TM4 2019.

## Çmimet

Rënia e aktivitetit ekonomik në vitin 2020 është shoqëruar me presione të pritura deflacioniste në vend. Megjithatë, rikuperimi i evidentuar i dinamikave në sektor të caktuar ekonomik gjatë TM1 2021 si dhe rritja e kërkesës së jashtme dhe për pasoj, presioneve inflacioniste është përkthyer në rritje të çmimeve edhe në Kosovë. Në TM1 2021 është shënuar normë mesatare e rritjes së çmimeve prej 0.6 përqind, përderisa trendi rritës evidentohet përmes figurës 3. Ky trend i rritjes pritët të vazhdoj edhe në muajt në vazhdim, ku sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit për vitin 2021 pritët të jetë rreth 2 përqind. Të ngjashme me parashikimet e BQK-së janë edhe pritjet e bankave komerciale, të cilat, në anketën e fundit të realizuar në muajin prill 2021, kanë deklaruar se presin që niveli i inflacionit do të jetë 1.9 përqind në vitin 2021.

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Rritje e çmimeve në TM1 2021 është shënuar tek mjetet e komunikimit, pijet alkoolike dhe duhani, shërbimet shëndetësore, arsimore, hoteliere, etj. Me rritje të ngadalësuar janë karakterizuar edhe çmimet

e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, mirëpo për shkak të peshës së madhe në shportën e konsumatorit kosovarë, kontribuuan pozitivisht me 0.10 pikë përqindje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve. Në anën tjetër, rënie të çmimeve kanë shënuar strehimi, uji, energjia elektrike, pastaj shërbimet e transportit, çmimet e veshmbathjes si dhe çmimet e orendive (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin gjatë TM1 2021

Përshkrimi	Peshat 2020	Norma e inflacionit	Kontributi
<b>GJITHSEJ</b>	100.0%	0.6	0.59
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.1%	0.2	0.10
Pijet alkoolike dhe duhani	5.7%	3.3	0.21
Veshmbathja	4.1%	-0.8	-0.03
Strehimi, uji, energjia elektrike	7.7%	-2.6	-0.19
Orenditë	7.6%	-0.4	-0.03
Shëndetësia	2.1%	2.1	0.04
Transporti	15.7%	-1.8	-0.27
Komunikimi	3.8%	16.1	0.56
Rekreacioni	4.4%	0.7	0.03
Arsimi	1.0%	1.3	0.01
Hoteleria	3.2%	0.9	0.03
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.5%	1.4	0.06

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

## Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> në TM1 2021 arritën vlerën neto prej 454.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.5 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore<sup>3</sup> shënuan rritje vjetore prej 30.5 përqind dhe arritën vlerën prej 487.5 milionë euro. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 32.6 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik në TM1 2021 rezulton të ketë ndikuar në një rritje të konsiderueshme të të hyrave tatimore direkte prej 15.0 përqind. Tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga financimi.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

12.9 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje prej 8.3 përqind. Me rritjen e kërkesës së brendshme, e cila ka ndikuar në rritjen e importit të mallrave, është shënuar rritje prej 14.3 përqind edhe në të hyrat tatimore indirekte, kategori që dominon të hyrat buxhetore me rreth 74 përqind. Në TM1 2021, të hyrat tatimore indirekte shënuan vlerën prej 336.3 milionë euro, ku TVSH-ja dhe akciza si dy kategoritë kryesore të tatimeve indirekte shënuan rritje prej 18.4 përkatësisht 10.5 përqind.

Masat e ndërmarra nga Qeveria për të zbutur efektet negative ekonomike dhe sociale nga kriza shëndetësore e pandemisë Covid-19 rezultuan në rritje të shpenzimeve buxhetore. Kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e shpenzimeve buxhetore gjatë TM1 2021 ishte ajo e subvencioneve dhe transfereve, e cila arriti vlerën prej 196.6 milionë euro apo 36.6 përqind më shumë krahasuar me TM1 2020. Shpenzimet për paga shënuan rritje prej 13.3 përqind dhe arritën vlerën prej 175.2 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 23.7 përqind dhe arritën vlerën 58.0 milionë euro. Shpenzimet kapitale u dyfishuan gjatë TM1 2021 duke arritur vlerën prej 57.9 milionë euro (28.4 milionë euro në TM1 2020).

Borxhi publik në TM1 2021 ka arritur në 1.5 miliardë euro, që është për 28.3 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind, nga 16.5 përqind sa ishte në TM1 2020. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes

së borxhit të brendshëm prej 27.7 përqind (që ka arritur në 1.0 miliardë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik për 29.4 përqind (që ka arritur në 516.8 milionë euro). Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 21.8 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe planeve të qeverisë për ta financuar deficitin buxhetor nëpërmjet borxhit publik.

#### **Sektori Financiar**<sup>4</sup>

Asetet e sistemit financiar në fund të marsit 2021 arritën vlerën në 8.07 miliardë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm më të përshpejtuar, kryesisht ndikuar nga zhvillimet në sektorin bankar dhe atë pensional.

Në baza kuartale, gjatë TM1 2021, në kuadër të sektorit bankar, aktiviteti kredidhënës shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga investimet në letrat me vlerë, dhe parasë së mbajtur në bankat komerciale. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizuan edhe kategoria e burimeve vetanake (nga fitimi i mbajtur dhe i realizuar). Për më tepër, bankat vazhdojnë të jenë mirë të kapitalizuara, likuiditet të mjaftueshëm dhe me cilësi të lartë të portfolios kreditore.

<sup>4</sup> Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM1 2021) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.



Sektori pensional gjatë TM1 2021 u zgjerua si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe kontributeve të arkëtuara nga kontributdhënësit, duke rikuperuar kështu plotësisht tërheqjen e 10 përqind të mjeteve të trusti, në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike në fund të vitit 2020.

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit dhe nivel më të lartë të primeve të arkëtuara. Mirëpo, niveli më i lartë i dëmeve të paguara (siguruesit dhe BKS-ja), ndikoi që sektori të operonte me humbje në TM1 2021.

Gjatë TM1 2021 sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje të kreditimit, performancë pozitive financiare, si dhe me nivel të ulët të kredive jo-performuese.


Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë prej 85.0 milionë euro, ku kërkesa për të investuar në fletëobligacione qeveritare ishte për 2.18 herë më e lartë se sa kërkesa e Qeverisë së Kosovës.

### Sektori i Jashtëm

Kanali kryesor përmes të cilit është transmetuar kriza ekonomike dhe sociale e nxitur nga pandemia Covid-19 në Kosovë ka qenë sektori i jashtëm i ekonomisë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2020 është rritur për 20.4 përqind dhe ka arritur vlerën prej 480.7 milionë euro. Trendi i përsheptuar i rritjes së deficitit të llogarisë rrjedhëse ka vazhduar edhe në TM1 2021. Nga 72.5 milionë euro sa ishte në TM1 2020 është më shumë se dyfishuar në TM1 2021 duke arritur në 154.0 milionë euro. Në kuadër të bilancit të pagesave, bilanci

pozitiv i shërbimeve si dhe të ardhurat dytësore kanë shënuar rritje, ndërsa deficiti i mallrave është thelluar (figura 4).


Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK.

Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të eksportit të mallrave, rritja e importit ka ndikuar që deficiti në tregtinë e mallrave<sup>5</sup> të shënoi rritje prej 20.0 përqind duke arritur nivelin prej 767.3 milionë euro (figura 5).

Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK.

Vlera e eksportit të mallrave në TM1 2021 ishte 152.8 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 57.4 përqind. Me rritje të eksportit të mallrave u karakterizuan pothuajse të gjitha kategoritë, ndërsa

<sup>5</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

rritja më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, është shënuar tek metalet bazë, tekstili dhe artikujt e tekstilit, makineritë dhe pajisjet elektrike, si dhe produktet e plastikës dhe gomës (figura 6). Rritja e eksportit të metaleve, ndër të tjera, mund t'i atribuohet rritjes së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare prej 38.2 përqind në TM1 2021.

**Figura 6. Eksporti i mallrave, në milionë euro**




Burimi: ASK.

Vlera e importit të mallrave arriti në 920.1 milionë euro në TM1 2021, që paraqet rritje prej 24.9 përqind. Në rritjen e importit ka ndikuar kryesisht niveli më i lartë i importit të makinerive dhe pajisjeve elektrike, mjeteve të transportit, produkteve të industrisë kimike, etj. Në anën tjetër, importi i perimeve u karakterizuan me rënie (figura 7).

Në kuadër të bilancit të pagesave, tregtia me shërbime pësoi rënien më të madhe gjatë vitit 2020 si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore. Sidoqoftë, në dy tremujorët e fundit bilanci i shërbimeve ka filluar të përmirësohet. Në TM1 2021, bilanci në tregtinë e shërbimeve, shënoi vlerën prej 143.4 milionë euro apo 1.3 përqind më shumë krahasuar me TM1 2020.

Vlera e eksportit të shërbimeve shënoi rritje për 1.0 përqind dhe arriti vlerën 284.3 milionë euro. Rritjen më të lartë e kanë shënuar eksporti i shërbimeve pensionale dhe të sigurimit si dhe shërbimet e ndërtimit ndërsa shërbimet e udhëtimit shënuan rënie prej 8.7 përqind në TM1 2021.

**Figura 7. Importi i mallrave, në milionë euro**




Burimi: ASK.

Edhe importi i shërbimeve ka shënuar një rritje të lehtë në TM1 2021, ku vlera e shërbimeve të importuara ishte 140.8 milionë euro, apo 0.6 përqind më shumë krahasuar me TM1 2020. Rritja më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të transportit si dhe shërbimet pensionale dhe të sigurimit, ndërsa shërbimet e udhëtimit, sikurse tek eksporti edhe tek importi kanë shënuar rënie (2.8 përqind).

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi rënie për 21.5 përqind në TM1 2021, kryesisht si rezultat i të ardhurave nga investimet, ndërkohë që edhe të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve shënuan rënie. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 14.2 përqind, kryesisht si rezultat i nivelit më të lartë të remitencave. Norma e lartë e rritjes së remitencave në vitin 2020, përkundër situatës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19, ka vazhduar edhe në TM1 2021 ku niveli i remitencave ka arritur në 242.9

milionë euro apo 29.7 përqind më shumë krahasuar me TM1 2020 (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK.

Sa i përket kanaleve të transferimit, pjesa dërmuese e remitencave (61.2 përqind) kanë ardhur përmes agjencive për transfer të mjeteve, të cilat shënuan rritje prej 41.3 përqind në TM1 2021. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 43.3 përqind, ndërsa remitencat përmes 'kanalit jo-formal' shënuan rritje për 3.4 përqind. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat u dërguan 42.3 përkatësisht 22.3 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (6.4 përqind e gjithsej remitencave).

Investimet e Huaja Direkte (IHD), në TM1 2021, arritën vlerën prej 106.6 milionë euro, që paraqet rritje prej 2.0 përqind. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione shënoi rritje prej 40.6 përqind, ndërsa instrumentet e borxhit shënuan rënie për 68.9 përqind krahasuar me TM1 2020 (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK.

Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorët e patundshmërive, ndërtimtarisë, aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, tregtisë, etj. ndërsa në sektorët e energjisë, xehtarisë dhe guroreve, informacion dhe komunikim, etj. është shënuar rënie e IHD-ve.

**Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 34, TM1 2021, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

**Referencat:**

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: [Letrat me Vlerë të Qeverisë | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit \(IHÇK\), Qershor 2021 | \(rks-gov.net\)](#)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit \(IÇP\), TM1 2021 | \(rks-gov.net\)](#)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [Indeksi i Çmimeve të Importit \(IÇIMP\), TM1 2021 | \(rks-gov.net\)](#)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: [Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, TM1 2021 | \(rks-gov.net\)](#)
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: [Statistikat e Tregtisë së Jashtme \(STJ\), Maj 2021 | \(rks-gov.net\)](#)

IMF (2021): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](#)

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Mars 2020	Mars 2021
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,410.0	1,493.0
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.1%	0.6%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.8%	1.2%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	397.3	454.9
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	373.7	487.5
Bilanci primar (në milionë euro)	23.5	-32.6
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,174.0	8,067.7
prej të cilave: Bankat	4,721.9	5,449.2
Kredi	3,083.3	3,320.8
Depozita	3,845.4	4,422.9
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.28%	6.12%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.32%	1.39%
Hendeku i normës së interesit	5.0%	4.7%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-72.5	-154.0
prej të cilave: remitencat e pranuar	187.3	242.9
Llogaria financiare	-103.5	-96.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	104.5	106.6
Investimet portfolio, net	-17.4	94.2
Investimet tjera, net	29.1	-3.8
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-592.2	-887.4
Asetet	5,054.3	5,348.4
Detyrimet	5,646.6	6,235.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,206.9	2,513.8
Borxhi i jashtëm privat	1,717.5	1,907.3
Borxhi i jashtëm publik	489.4	606.5

Burimi:

1/ ASK (2021);

2/ MF (2021);

3/ BQK (2021).

